

VENDIM
Nr. 49, datë 1.7.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 6, paragrafi 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4) Shkronja “a” dhe “b” e paragrafit 2 të këtij neni është në fuqi deri në datën 1 janar 2016.”;

b) “Aneksi 8”, formulari i raportimit nr. 2 ndryshon sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi;

c) në nenin 12, paragrafi 4 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4) Bankat ponderojnë me 0% ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, të emetuara dhe financuara në monedhë kombëtare dhe me 50% titujt e borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj.”.

2. Ndryshimet sipas shkronjës “c” të paragrafit 1 janë të vlefshme për një periudhë kohore deri në datën 1 janar 2021.

3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

ANEKSI 8

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

Nr.	Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit, të ponderuara me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit	Mënyra e llogaritjes
1.	Portofoli i kredisë bruto në dhjetor 2014	(a)
2.	Portofoli i kredisë bruto në periudhën raportuese 2015	(b)
3.	Rritja e portofolit të kredisë 2015	(c) = (b) - (a)
4.	Rritja e portofolit të kredisë për 2015-n me bazë vjetore sipas periudhës raportuese: nëse periudha raportuese është mars 2015 nëse periudha raportuese është qershor 2015 nëse periudha raportuese është shtator 2015 nëse periudha raportuese është dhjetor 2015	(d) = (c) * 4; (d) = (c) * 2; (d) = (c) * 3/4; (d) = (c)
5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit, 2014	(e) = (a) * 4%
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2014	(f) = (a) * 10%
7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik, vetëm për periudhën raportuese 2015	(g) = 0 nëse (d) < (e); (g) = (c) nëse (e) < (d) < (f); (g) = (f)/4 nëse (d) > (f) dhe periudha raportuese është mars 2015 (g) = (f)/2 nëse (d) > (f) dhe periudha raportuese është qershor 2015 (g) = (f)/(4/3) nëse (d) > (f) dhe periudha raportuese është shtator 2015 (g) = (f) nëse (d) > (f) dhe periudha raportuese është dhjetor 2015